
FEMICIDE – THE MOST EXTREME FORM OF VIOLENCE AGAINST WOMEN

Albana Metaj-Stojanova

South East European University, Republic of North Macedonia, a.metaj@seeu.edu.mk

Abstract: Femicide or feminicide is a sex-based hate crime term, defined as intentional killing of women or girls because they are females. Gender-related killings are the extreme manifestation of existing forms of violence against women. Such killings are not isolated incidents that arise suddenly and unexpectedly, but represent the ultimate act of violence which is experienced in a continuum of violence. Femicide is on the extreme end of a continuum of antifemale terror that includes a wide variety of verbal and physical abuse, such as rape, torture, sexual slavery, child sexual abuse, physical and emotional battery, sexual harassment, genital mutilation, unnecessary gynecological operations, forced heterosexuality, forced sterilization, forced motherhood, psychosurgery, denial of food to women in some cultures, cosmetic surgery, and other mutilations in the name of beautification. Whenever these forms of terrorism result in death, they become femicides. Femicide has been globally identified as the leading cause of premature death in women. Notwithstanding the fact that it is the most extreme manifestation of male violence against women, yet there are limited data on femicide. Femicide occurs in all countries of the world. The biggest concern stems from the fact that these killings continue to be invisible, accepted, tolerated or justified as part of tradition, and the rule of impunity continues to exist. Hence, in order to prevent femicide, the practice of impunity must be changed, perpetrators must be brought to justice, and work must be done to change everyone's individual attitudes toward women and their role in society. There are different types of femicide, such as: femicide as a consequence of domestic violence or intimate partner violence, killings of women and girls in the name of "honor", femicide because of dowry, femicide linked to organized crime, intentional killings of women in war, female infanticide and gender-based sex selective femicide, femicide as a result of genital mutilation and murders of women accused of witchcraft or sorcery, misogynistic killing of women, murders of women and girls because of their sexual orientation and gender identity. There are active or direct forms of femicide and passive or indirect forms. More than four decades have passed since Diana Russell coined the word "femicide", during the proceedings of the First International Tribunal on Crimes against Women in Brussels in 1976. From that point on, researchers have followed different approaches to the analysis of femicide: a feminist approach, which confronts patriarchal domination at the same time as it investigates the killing of women; a sociological approach, which focuses on the examination of the features special to the killing of women that make it a separate phenomenon; a criminological approach, which distinguishes femicide as a unique sector in "homicide" studies; a human rights approach, which extends femicide beyond the lethal and into extreme forms of violence against women. This paper aims to provide an overview of the different types of femicide, risk factors, the international legal framework that directly refers to this issue, as well as the legislation of the Republic of Northern Macedonia. This study is based on the need to understand the severity of femicide, as well as the need to prevent and protect victims of this type of violence.

Keywords: femicide, violence against women, gender-based violence, misogyny

FEMICIDI – FORMA MË EKSTREME E DHUNËS NDAJ GRAVE

Albana Metaj-Stojanova

Universiteti i Evropës Juglindore, Republika e Maqedonisë së Veriut, a.metaj@seeu.edu.mk

Abstrakt: Femicidi apo feminicidi është një term i përdorur për krimet e urrejtjes me bazë gjinore, i pranuar gjerësisht si vrasje me dashje e grave dhe vajzave sepse ato janë femra. Vrasjet me bazë gjinore janë një manifestim ekstrem i formave ekzistuese të dhunës ndaj grave. Këto vrasje nuk janë incidente të izoluara dhe të papritura, por ato janë forma më e rëndë e dhunës ndaj grave, të cilës i paraprijnë vite të tëra dhune. Femicidi është në skajin ekstrem të një terrori të vazhdueshëm kundër femrave që përfshin një sërë abuzimesh verbale dhe fizike, siç janë përdhunimi, torturimi, skllavëria seksuale, abuzimi seksual i fëmijëve, dhuna fizike dhe emocionale, ngacmimi seksual, gjymtimi i organeve gjenitale, operacionet e panevojshme gjinekologjike, heteroseksualiteti i detyruar, sterilizimi i detyruar, amësia e detyruar, psikokirurgjia, mohimi i ushqimit për gratë në disa kultura, kirurgjia kozmetike dhe gjymtimet e tjera në emër të zburimit. Sa herë që këto forma të terrorizmit rezultojnë me vdekje, ato kthehen në femicid. Femicidi është identifikuar globalisht si shkaku kryesor i vdekjes së parakohshme tek gratë. Megjithatë është manifestimi më ekstrem i dhunës mashkullore ndaj grave, ende ka të dhëna të kufizuara për femicidin. Femicidi ndodh në të gjitha vendet e botës. Shqetësimi më i madh buron nga fakti se këto vrasje

vazhdojnë të jenë të padukshme, të pranuar, të toleruara ose të justifikuar si pjesë e traditës, dhe rregulli i mosndëshkimit vazhdon të ekzistojë. Për të parandaluar femicidin, duhet të ndryshohet praktika e mosndëshkimit, autorët duhet të nxirren para drejtësisë dhe duhet të punohet për të ndryshuar qëndrimet individuale të secilit ndaj grave dhe rolit të tyre në shoqëri. Ekzistojnë lloje të ndryshme të femicidit, siç janë: femicidi si pasojë e dhunës në familje apo dhunës nga partneri intim, vrasjet e grave dhe vajzave në emër të “nderit”, femicidi për shkak të pajës, femicidi i lidhur me krimin e organizuar, vrasjet e qëllimshme të grave në luftë, infanticidi femëror dhe feticidi i bazuar në përzgjedhjen gjinore, femicidi si rezultat i gjymtimit gjenital dhe vrasjet e grave të akuzuara për magji, vrasja misogjinike e grave, vrasjet e grave dhe vajzave për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Dallohen forma aktive apo direkte të femicidit dhe forma pasive apo indirekte të tij. Kanë kaluar më shumë se katër dekada që kur Diana Russell përdori për herë të parë fjalën “femicid” gjatë procedimeve të Gjykatës së Parë Ndërkombëtare për Krimet kundër Grave në Bruksel në vitin 1976. Që nga ajo kohë e deri më sot, studiuesit kanë ndjekur qasje të ndryshme për të analizuar femicidin: qasja feministe, e cila përballet me dominimin patriarkal duke hetuar në të njëjtën kohë vrasjen e grave; qasja sociologjike, e cila përqendrohet në ekzaminimin e tipareve të vrasjes së grave që e bëjnë atë një fenomen më vete; qasja kriminologjike, e cila e dallon femicidin si një sektor të veçantë në studimin e vrasjeve në përgjithësi; qasja e të drejtave të njeriut, sipas së cilës femicidi është më tepër se vdekjeprurës dhe përbën formën më ekstreme të dhunës ndaj grave dhe shkeljen më flagrante të të drejtave të njeriut. Ky punim ka për qëllim të bëjë një pasqyrim të llojeve të ndryshme të femicidit, faktorëve rrezik, kornizës ligjore ndërkombëtare që i referohet drejtpërdrejt kësaj problematike si dhe legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky punim bazohet në nevojën për të kuptuar ashpërsinë e femicidit, si dhe nevojën për të parandaluar dhe mbrojtur viktimat e këtij lloji të dhunës.

Fjalë kyçe: femicid, dhunë kundër grave, dhunë me bazë gjinore, misogjini

1. HYRJE

Termi “femicid” është shkurtim i termit me prejardhje nga latinishtja “*feminicid*”, që në aspektin etimologjik do të thotë vrasje e femrës (e përbërë nga fjala “*femina*” që do të thotë “femër” dhe “*caedo*” që do të thotë “vrasje”). Të dyja termat gjejnë përdorim të gjerë e të alternuar në literaturë, ku termi “femicid” përdoret më tepër në hulumtimet në gjuhën angleze, ndërsa “feminicid” në gjuhët neo-latine. (Corradi, Marcuello-Servos, Boira & Weil, 2016) Është e pranuar gjerësisht se termi “femicid” ose “feminicid” nënkupton vrasjen me dashje të grave dhe vajzave sepse ato janë femra. Terma të tjerë të përdorur janë vrasje për çështje “nderi” dhe vrasje pasionale. Një term tjetër është dhe “gendercid” (nga anglishtja “*gendercide*”) që është term shumë më gjithëpërfshirës. Për herë të parë termi “femicid” u përdor publikisht, pikërisht për të përcaktuar vrasjen me dashje të grave dhe vajzave sepse janë femra, në vitin 1976 gjatë procedimeve të Gjykatës së Parë Ndërkombëtare për Krimet kundër Grave në Bruksel nga feministja Diana Russell. (Russell & Van de Ven, 1990) Përkufizimi i Russell për femicidin vlen për të gjitha format e vrasjeve seksiste, qofshin ato të motivuara nga misogjini (apo urrejtja e femrave), nga një ndjenjë epërsie ndaj femrave, nga kënaqësia seksuale, ose nga supozimi i pronësisë mbi gratë. (Russell & Harmes, 2001). Megjithatë, sot ky term përdoret në kuptim më të gjerë dhe përfshin të gjitha vrasjet e femrave. Disa feministe janë të mendimit se motivet që çojnë në femicid janë shumë të ndryshme nga motivet e vrasjeve të tjera. Në fakt, fokusi nuk vendoset tek dhuna që ndodh në rrugë, por tek dhuna që ndodh në shtëpi apo që shkaktohet nga personat më të afërt të viktimës. Femicidi ndryshon nga termi jo-gjinor “vrasje” pikërisht sepse termi “femicid” ilustron faktin që gratë vriten për arsye dhe motive të ndryshme nga ato që lidhen me përkrahjet tipike të vrasjes. (Radford & Russell, 1992) Këto vrasje nuk janë incidente të izoluar dhe të papritura, por ato janë forma më e rëndë e dhunës ndaj grave, të cilës i paraprijnë vite të tëra dhune. (Manjoo, 2012) Dhuna në familje dhe forma e saj më ekstreme, femicidi, është rezultat i drejtpërdrejtë i diskriminimit dhe marrëdhënieve të pabarabarta midis burrave dhe grave. Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e këtyre fenomeneve janë të llojeve të ndryshme: faktorë socio-kulturorë, ekonomikë, ligjor dhe politik. (Netkova, 2007) Femicidi është në skajin ekstrem të një terrori të vazhdueshëm kundër femrave që përfshin një sërë abuzimesh verbale dhe fizike, siç janë përdhunimi, torturimi, skllavëria seksuale, abuzimi seksual i fëmijëve, dhuna fizike dhe emocionale, ngacmimi seksual, gjymtimi i organeve gjenitale, operacionet e panevojshme gjinekologjike, heteroseksualiteti i detyruar, sterilizimi i detyruar, amësia e detyruar, psikokirurgjia, mohimi i ushqimit për gratë në disa kultura, kirurgjia kozmetike dhe gjymtimet e tjera në emër të zbulimit. Sa herë që këto forma të terrorizmit rezultojnë me vdekje, ato kthehen në femicid. (Russell, 2011) Megjithatë, dhuna ekstreme, femicidi, mund të ndodhë dhe në kontekste relacionale të kontrollit dhe frikësimit nga mashkulli, ku mungojnë shenjat parandaluese të pritshme të përshkallëzimit të sulmeve dhe dëmtimeve. Kontrolli i mashkullit ndaj partneres femër është i mundshëm dhe gjerësisht i praktikuar dhe i pranuar nga shoqëria në ditët tona në kontekste ku dhuna fizike është e papranueshme dhe ky kontroll nuk shërben si paralajmërim që sinjalizon rrezikun e dhunës vdekjeprurëse. (Johnson, Eriksson, Mazerolle & Wortley, 2019)

Femicidi është identifikuar në nivel global si arsyeja kryesore për vdekje të parakohshme tek gratë. Kështu, sipas një Studimi global mbi vrasjet të Zyrës së Kombeve të Bashkuara të vitit 2019, më shumë se gjysma e vrasjeve të grave është kryer nga një partner intim ose nga anëtar i familjes. Vihet re një rritje e numrit të përgjithshëm të grave të vrara nga partnerët intimë ose anëtarët e familjes, krahasuar me vitin 2012. Në vitin 2012, 47% e numrit të përgjithshëm të vrasjeve të grave ishin kryer nga partnerët intimë ose anëtarët e familjes, ndërsa në vitin 2017, kjo shifër shkon në 58%. (United Nations Office on Drugs and Crime, 2019) Kjo tregon se shtëpia vazhdon të mbetet vendi më i rrezikshëm për gratë, të cilat vazhdojnë të bartin peshën më të rëndë të viktimizimit që vjen si rezultat i pabarazisë dhe stereotipeve gjinore. Në dhjetor të vitit 2013, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 68/191 kundër vrasjeve me bazë gjinore të grave dhe vajzave, duke i nxitur shtetet anëtare të ndërmarrin një sërë masash për të adresuar vrasjet me bazë gjinore të grave dhe vajzave, përfshirë dhe nevojën për të analizuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Në raportin e raportueses speciale të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave, Dubravka Simonovic, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ajo thekson se Kombet e Bashkuara dhe vendet anëtare të saj kanë konstatuar në mënyrë të përsëritur se disponimi dhe krahasimi i të dhënave janë thelbësore për përcaktimin dhe kuptimin e femicidit dhe manifestimeve, shkaqeve dhe pasojave të tij. Ajo rekomandon që shtetet të mbledhin dhe publikojnë të dhëna mbi femicidet dhe format e tjera të dhunës ndaj grave dhe të krijojnë “Femicide Watch” apo vëzhgues të femicideve dhe observatorë për dhunën ndaj grave me funksione të tilla. (Simonovic, 2016) Studiuesit kanë ndjekur qasje të ndryshme për të analizuar femicidin: qasja feministe, e cila përballet me dominimin patriarkal duke hetuar në të njëjtën kohë vrasjen e grave; qasja sociologjike, e cila përqëndrohet në ekzaminimin e tipareve të vrasjes së grave që e bëjnë atë një fenomen më vete; qasja kriminologjike, e cila e dallon femicidin si një sektor të veçantë në studimin e vrasjeve në përgjithësi; qasja e të drejtave të njeriut, sipas së cilës femicidi është më tepër se vdekjeprurës dhe përbën formën më ekstreme të dhunës ndaj grave dhe shkeljen më flagrante të të drejtave të njeriut. (Corradi, et al, 2016) Gjithsesi për shkak të kompleksitetit të problemit është e nevojshme një qasje multidisiplinare.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, femicidi nuk njihet si vepër penale e veçantë nga Kodi Penal, por klasifikohet si çdo vrasje tjetër. Megjithatë, këto vrasje nuk janë incidente të izoluara dhe të papritura, por ato janë forma më e rëndë e dhunës ndaj grave, të cilës i paraprijnë vite të tëra dhune. Femicidi është në skajin ekstrem të një terrori të vazhdueshëm kundër femrave që përfshin një sërë abuzimesh verbale dhe fizike, siç janë përdhunimi, torturimi, skllavëria seksuale, abuzimi seksual i fëmijëve, dhuna fizike dhe emocionale, ngacmimi seksual, gjymtimi i organeve gjenitale, operacionet e panevojshme gjinekologjike, heteroseksualiteti i detyruar, sterilizimi i detyruar, amësia e detyruar, psikokirurgjia, mohimi i ushqimit për gratë në disa kultura, kirurgjia kozmetike dhe gjymtimet e tjera në emër të zburimit. Sa herë që këto forma të terrorizmit rezultojnë me vdekje, ato kthehen në femicid. Dhuna në familje ose dhuna e një partneri intim që i paraprin vrasjes konsiderohet si rrethanë rënduese në procedurat gjyqësore dhe shqiptimin e dënimeve për veprat e caktuara penale. Veprat penale trajtohen në kapituj të ndryshëm të Kodit penal, bazuar në objektin e ndryshëm të mbrojtjes, dhe e drejta penale maqedonase njeh dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike si forma të dhunës në familje. Kështu, në kapitullin XIV të titulluar “Veprat penale kundër jetës dhe trupit” përfshihen veprat penale me të cilat kryhet dhunë fizike, përkatësisht Vrasja (neni 123 paragrafi 2, pika 2), Lëndimi trupor (neni 130 paragrafi 1 dhe 2) dhe Lëndimi i rëndë trupor (neni 131, paragrafi 1 dhe 2 i KP). Në kapitullin XV, të titulluar “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit” përfshihen veprat penale me të cilat kryhet dhunë psikologjike, përkatësisht Shtërëngimi (neni 139, paragrafi 1 dhe 2), Privimi i paligjshëm i lirisë (neni 140, paragrafi 1 dhe 2) dhe Rrezikimi i sigurisë (neni 144, paragrafi 1 dhe 2). Në kapitullin XIX, të titulluar “Veprat morale kundër lirisë dhe moralit seksual” përfshihen veprat penale me të cilat kryhet dhunë seksuale, përkatësisht Përdhunimi (neni 186), Marrëdhëniet seksuale me fëmijë (neni 187), Sulmi seksual ndaj një fëmije që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç (neni 188, paragrafi 2) dhe Ndërmjetësimi në ushtrimin e prostitucionit (neni 191, paragrafi 1). Vlen të theksohet se Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk e njeh dhunën ekonomike si formë të veçantë të dhunës në familje. Gjithashtu, nuk ka të dhëna statistikore për numrin e grave të vrara.

Sipas të dhënave të Rrjetit kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të përfshira në Raportin e monitorimit të zbatimit të Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, në periudhën nga viti 2001 deri në gusht të vitit 2016, janë regjistruar 32 femicide. 15 nga këto vrasje kanë ndodhur nga viti 2013-2016. (Calovska-Dimovska, 2016) Këto janë të dhëna statistikore jozyrtare që vijnë nga organizatat joqeveritare për shkak të mungesës së një sistemi të përshtatshëm për regjistrimin e femicideve nga ana e shtetit. Edhe në nivel global, femicidet rrallëherë janë hetuar veçmas nga vrasjet, dhe qëllimi i shumë autorëve të kësaj fushe është që femicidi të trajtohet si një kategori më vete. (Campbell & Runyan, 2016)

2. LLOJET E FEMICIDIT

Sipas një publikimi të Këshillit Akademik të Sistemit të Kombeve të Bashkuara, ekzistojnë disa lloje të femicidit, siç janë:

Femicidi si pasojë e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim – Femicidet që ndodhin si pasojë e dhunës në familje shpesh quhen dhe “vrasje nga partneri intim”. Përkufizohen si vrasje e gruas nga partneri intim ose nga një person me të cilin viktima është në marrëdhënie të ngushtë, sepse ajo është grua. Këtu përfshihen vrasjet e grave nga bashkëshorti apo partneri i mëparshëm apo aktual, por nuk përfshihen as vrasja e grave nga anëtarë të tjerë meshkuj të familjes siç janë babai apo djali. Nëse dhuna e vazhdueshme në familje mbetet e padeklaruar, ose intencionet përkatëse nuk ofrojnë mbrojtje të përshtatshme për viktimën, ka shumë gjasa që dhuna të përshkallëzohet deri në femicid.

Vrasjet e grave dhe vajzave në emër të “nderit” – Vrasjet në emër të “nderit” janë forma më ekstremeve e krimeve në emër të “nderit”, të cilat kanë për qëllim të kontrollojnë sjelljen e grave. Viktimat janë pothuajse gjithmonë femra në adoleshencën e vonë dhe adoleshencën e hershme. Shpesh, vendimin për atë nëse një grua apo vajzë duhet të vritet, dhe nëse po, si duhet të vritet e merr këshilli familjar, i përbërë zakonisht nga burrat e familjes, të cilët mbledhen për të zgjidhur probleme apo për të vendosur për çështje në interes të përbashkët. Vrasjet kryhen nga anëtarët e familjes ose nga ndonjë vrasës me pagesë. Vrasjet në emër të “nderit” janë opsioni i fundit të cilit i paraprijnë forma të tjera të dhunës për shkak të “nderit”, si martesat e detyruara, kërcënimet dhe ngacmimet. “Gabimi” ose “krimi” që ka kryer viktima, shpesh ka të bëjë me zgjedhjen e partnerit seksual ose martesor, me edukimin ose punësimin, kodin e veshjes, sjelljen dhe kontaktin me seksin e kundërt, seksualitetin ose mosrespektimin e përgjithshëm të standardeve të vendosura nga familja apo shoqëria për “sjelljen e femrës”. Gratë viktima të përdhunimit shpesh vriten për “rikthimin e nderit të familjes”. Pra, ajo që ka ndodhur ndikon në nderin e familjes dhe përmes vrasjes familja mund ta rikthejë nderin në komunitet. Nëse familja nuk e vret viktimën, ajo mund të ngacmohet e refuzohet nga komuniteti, e gjithashtu asaj mund t’i bëhet presion për ta kryer vrasjen. Vrasja kryhet më shpesh në vende publike me qëllim që të ndikojë dhe në sjelljen e grave të tjera në komunitet. Këto vrasje janë më të përhapura në Lindjen e Mesme dhe Azinë e Jugut, megjithatë ato ndodhin në shumicën e vendeve të botës.

Femicidi për shkak të pajës – Vrasjet e grave për shkak të pronës kanë të bëjnë me një lloj të veçantë femicidi, i cili më së shpeshti ndodh brenda shtëpisë. Pra, në momentin kur prindërit nuk do të kenë më mjete financiare për t’i dhënë vajzës, domethënë kur ajo nuk do të jetë më burim të ardhurash për familjen e burrit, burri mund të vendosë që ajo nuk është më një grua e përshtatshme. Tradita e dhënies së dhuratave familjes së dhëndrrit me kalimin e kohës ndryshon dhe kthehet në presion dhe torturë për anëtarët e familjes së nuses për të siguruar para, bizhuteri, automjete, etj., nëse nuk duan që vajza apo motra e tyre të vritet ose të detyrohet të kryejë vetëvrasje. Studimet tregojnë se ky lloj femicidi është i pranishëm në Afrikë dhe në Azinë Juglindore, ndërsa si praktikë haset më shpesh në Indi dhe Pakistan.

Femicidi i lidhur me krimin e organizuar – Në dekadat e fundit është shfaqur një tendencë e re në kartelet e trafikut të drogës. Vihet re njëkohësisht si rritja e sasisë së drogës së trafikuar, ashtu dhe numri i grave të vrara. Femicidet e lidhura me trafikimin e drogës kanë domethënie simbolike dhe janë të lidhura me “*macho*” kulturën. Pikërisht, nëpërmjet vrasjes së gruas së armikut, në fakt ata e dëmtojnë atë dhe rrisin fuqinë e tyre duke marrë apo dëmtuar “pronën” e tij. Trafikantët e drogës mund të përdorin vrasjen e një gruaje dhe për t’i dërguar mesazhe autoriteteve, për shembull për t’i paralajmëruar ato për politikën e lidhura me trafikun e drogës. Prej kësaj arrijmë në përfundimin se në botën e drogës, grate trajtohen si objekte, si mjete për arritjen e ndonjë qëllimi, apo si pronësi e armikut ndaj të cilit kërkohet hakmarrje. Vetë fakti që grate përdoren për trafikimin e drogës, pa marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore apo mundësinë e kapjes dhe përgjegjësisë penale, tregon për vlerën e grave në këto rrethe. Ky lloj femicidi është më i zakonshëm në Amerikën Latine.

Vrasjet e qëllimshme të grave në luftë – Kombet e Bashkuara i kanë përshkruar këto vrasje si “përdorim i qëllimshëm, i paramenduar dhe i tepruar i forcës vdekjeprurëse nga shteti ose nga autoritetet e tij, të cilët veprojnë në emër të ligjit, apo nga ana e grupeve të organizuara të armatosura gjatë konflikteve, kundër individëve që nuk mbahen peng”. (Alston, 2010) Kjo praktikë mund të shfaqet dhe në kohë paqeje. Ajo që i veçon këto vrasje nga llojet e tjera të vrasjeve është se forca vdekjeprurëse përdoret në një target grup të paracaktuar. Në konfliktet e armatosura, grate dhe vajzat shpesh shënjestrohen dhe vriten si pjesë e strategjisë ushtarake, jo vetëm për të dobësuar familjen e viktimës, por edhe për të ndikuar tek komuniteti në përgjithësi. Pra, grate përdunohen dhe vriten për të treguar dominim dhe force dhe për të ndëshkuar armikun. Kjo formë e dhunës përdoret si armë lufte. Shembujt më të dukshëm të këtij lloji të vrasjeve janë lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë apo Kosovë dhe genocidi i Ruandës.

Infanticidi femëror dhe feticidi i bazuar në përzgjedhjen gjinore - Këto forma të dhunës dhe vrasjeve praktikohen në vendet ku vlera e fëmijës mashkull është më e madhe se vlera e femrës. Pikërisht, ndërprerja e dhunshme e

shtatëzanië kryhet kur zbulohet seksi i fëmijës gjatë shtatëzanië (feticid selektiv), ndërsa nëse fëmija femër tashmë ka lindur, ajo lihet pas dore, neglizhohet, lihet të vuajë nga uria deri sa të vdesë (infanticidi femëror). Arsyet lidhen me shpenzimet më të mëdha që ka familja për fëmijën femër, si dhe me potencialin më të ulët që ajo ka për të fituar para në të ardhmen. Infanticidi femëror është më i përhapuri në Indi dhe Kinë, ndërsa feticidi selektiv ndodh në shumë vende të tjera si Mali i Zi, Azerbajxhani, Gjeorgjia, Armenia etj. Disproporcioni gjinor i fëmijëve të lindur meshkuj dhe femra tregon ekzistencën e këtij fenomeni.

Femicidi si rezultat i gjymtimit gjenital dhe vrasjet e grave të akuzuara për magji - Gjymtimi i organeve gjenitale femërore është një praktikë e dëmshme tradicionale që largon organet gjenitale femërore pa ndonjë arsye mjekësore dhe më së shpeshti në kushte johigjenike. Më së shpeshti kryhet tek vajzat e vogla nga mosha 5 vjeçare, dhe për shkak të kushteve në të cilat kryhet, shumë shpesh shfaqen infeksione që çojnë deri në vdekje. Mospasja e objekteve shëndetësore në afërsi të vendit të banimit ndikon në rritjen e shkallës së vdekshmërisë. Si praktikë zbatohet në Afrikë, Azi dhe Lindjen e Mesme, megjithëse tashmë ekziston tendenca për ta rregulluar dhe ndëshkuar ligjërisht. Në Evropë ky fenomen paraqitet në Francë, Belgjikë, Norvegji dhe në vende të tjera ku ka emigrantë nga vende afrikane. Bashkimi Evropian tashmë ka miratuar politika dhe direktiva për mbrojtjen e vajzave dhe grave nga gjymtimi i organeve gjenitale. (Rezoluta 2019/2988 (RSP) e Parlamentit Evropian). Vrasjet e grave të akuzuara për magji janë të lidhura me akuzat të pabaza nga anëtarët e komunitetit që janë në konflikt me gruan ose familjen e saj, ose kanë konflikte të pazgjidhura pronësie. Megjithëse mendohet se vajzat e reja janë më të ekspozuara ndaj kësaj forme të femicidit, në disa pjesë të botës grate më të moshuara janë në rrezik më të madh, më shpesh për shkak të varësisë ekonomike nga të tjerët ose për shkak të pasurisë që duhet të trashëgohet nga anëtarët më të rinj të familjes. Në përgjithësi, nëse gruaja perceptohet si kërcënim për burrin apo nëse prej saj mund të merret ndonjë lloj përfitimi financiar, ajo etiketohet si shtrigë, me qëllim që vrasja e saj të justifikohet përpara komunitetit. Ky lloj i femicidit është më i pranishëm në Indi dhe në vendet afrikane.

Vrasjet misogjinike të grave – Misogjia përkuzohet si urrejtje patologjike ose paragjykim ndaj grave dhe vajzave. Si dukuri, bëhet kërcënuese për jetën e grave, kur qëndrimet shndërrohen në sjellje të dhunshme. Vrasjet brutale të grave dhe vajzave, të shoqëruara shpesh me përdhunime dhe tortura seksuale, kanë implikime të forta të misogjinisë. Shqetësues është fakti që këto vrasje ndodhin sin ë vendet në zhvillim, ashtu dhe në vendet e zhvilluara. Vrasjet seriale gjithashtu bëjnë pjesë në këtë lloj femicidi dhe përfaqësojnë formën më ekstreme të misogjinisë.

Forma të tjera të femicidit janë: vrasjet e grave dhe vajzave për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor, vrasjet e grave dhe vajzave aborigjene dhe indigjene për shkak të orientimit të tyre seksual, etj. (Academic Council on the United Nations System, 2013)

Sipas Raportueses speciale të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave, Rashida Manjoo, ekzistojnë forma aktive apo të drejtpërdrejta dhe pasive apo indirekte të dhunës ndaj grave. Format e drejtpërdrejta përfshijnë: vrasjet nga dhuna e partnerit intim, vrasjet e lidhura me magjinë, vrasjet në emër të “nderit”, vrasjet në konflikte të armatosura, vrasjet e lidhura me pajën, vrasjet për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual dhe vrasjet e lidhura me përkatësinë etnike dhe gratë indigjene. Format indirekte përfshijnë: vdekjet si pasojë e aborteve të kryera keq dhe aborteve të paligjshme, vdekshmërinë e nënave, vdekjet si rezultat i trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të drogës, krimit të organizuar, vdekjet e vajzave dhe grave për shkak të pakujdesisë dhe neglizhencës, urisë ose trajtimit të papërshtatshëm, apo si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të qëllimshme të shtetit. (Manjoo, 2012)

3. LEGJISLACIONI KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE QË ZBATOHEË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mbrojtja e viktimave dhe sanksionimi i dhunës në familje në sistemin ligjor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) realizohet si në kuadër të sistemit juridiko-penal, ashtu dhe në kuadër të sistemit juridiko-civil. Nëpërmjet ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal, dhe Ligjit për Familjen në vitin 2004, u reformua sistemi ligjor në aspekt të adresimit të fenomenit të dhunës në familje dhe për here të pare u mundësua mbrojtja e viktimave të dhunës në familje. Dhuna në familje nuk është e rregulluar si krim i veçantë në Kodin Penal, por sanksionohet brenda veprave penale ekzistuese duke shqiptuar dënime më të rrepta dhe ndjekje sipas detyrës zyrtare, në rastet kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të dhunës në familje. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Familjen të vitit 2004, u parashikuan një sërë masash për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, të ashtuquajturat masa të përkohshme për mbrojtje, të cilat i shqipton gjykata në procedurë të përsheptuar, ndërsa Qendrave për Punë Sociale dhe organizatave joqeveritare që punojnë në fushën e zhdokjes dhe parandalimit të dhunës në fmailje iu dha mundësia ligjore për të ndërtuar sistemin e nevojshëm të koordinimit të mbrojtjes. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Parandalimin, Pengimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në 1 janar të vitit 2015, u shfuqizuan dispozitat e Ligjit për Familjen që trajtonin dhunën në familje dhe tashmë kjo problematikë, në aspektin juridiko-civil është e rregulluar me ligjin e ri. Një nga risitë që solli ky ligj është krijimi i Trupit nacional koordinativ kundër dhunës në

familje, me përfaqësues nga të gjitha organet që kanë kompetenca në trajtimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Siç u theksua, femicidi shpesh është pasojë direkte e diskriminimit dhe marrëdhënieve të pabarabarta midis burrave dhe grave. Në këtë aspekt, një rol të rëndësishëm në arritjen, të paktën *de iure*, të barazisë midis burrave dhe grave luan Ligji për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat i vitit 2006 dhe Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të cilët përputhen plotësisht me direktivat e BE në këtë drejtim. RMV ka ratifikuar dhe disa nga konventat kryesore ndërkombëtare që i referohen drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte dhunës në familje siç janë: Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (dhe Rekomandimet nr. 19 dhe 35 që fokusohen pikërisht në këtë problem), Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), etj. RMV ka ende shumë për të bërë për ta përshatur legjislacionin dhe strukturat ndihmëse dhe mbështetëse për viktimat e dhunës në familje me standardet e vendosura nga Konventa e Stambollit.

4. PËRFUNDIME

Konsideroj se nevojitet përmirësim i legjislacionit aktual në aspekt të njohjes së vrasjeve me bazë gjinore si vepër e veçantë penale, apo si rrethanë rënduese, e cila do të shoqërohej me dënime më të rënda për kryerësit. Nevojitet definimi i saktë e i plotë i të gjitha formave të vrasjeve me bazë gjinore të grave, si dhe studimi dhe dokumentimi i kësaj forme ekstreme të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Nevojitet një sistem për mbledhjen e të dhënave për veprat penale sipas moshës, përkatësisë etnike të viktimës, motivit të vrasjes etj., si dhe krijimi i një Observatori vëzhgues për rastet e femicidit (Femicide Watch). Nevojiten më shumë shërbime të specializuara për gratë viktimat të dhunës në familje, të cilat do të jenë më të aksesueshme për viktimat, të ofruara në gjuhën amtare. Është i nevojshëm dhe forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial, sidomos në rastet që paraqesin rrezikshmëri të lartë, si dhe monitorimi i ligjeve, politikave dhe strategjive parandaluese.

REFERENCA

- Academic Council on the United Nations System. (2013). *Femicid: a global issue that demands action*.
- Alston, P. (2010). *Report of the Special Rapporteur on extrajudicial, summary or arbitrary executions*, (Report 14/24). United Nations General Assembly.
- Calovska-Dimovska, N. (2016). *Raport i monitorimit të zbatimit të Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje*. Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Corradi, C., Marcuello-Servos, C., Boira, S., & Weil, S. (2016). Theories of femicide and their significance for social research, *Current Sociology*, Vol. 64(7), DOI: 10.1177/0011392115622256
- European Parliament resolution of 12 February 2020 on an EU strategy to put an end to female genital mutilation around the world (2019/2988(RSP))
- General Assembly of the United Nations. (2013). *Resolution 68/191, Taking action against gender-related killing of women and girls*.
- Johnson, F., Eriksson, L., Mazerolle, P., & Wortley, P. (2019). Intimate femicide: The role of coercive control, *Feminist Criminology*, 14(1), 3–23. DOI:10.1177/1557085117701574
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Manjoo, R. (2012). *Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences* (Report 20/16). United Nations General Assembly.
- Netkova, B. (2007). *Covekovite prava i semejnoto nasilstvo so osvrt na Republika Makedonija*, Tetove, Univerzitet na Jugoistocna Evropa.
- Radford, J., & Russell, D.E.H. (1992). *"Femicide: the politics of women killings"*. New York, Twayne Publishers.
- Russell, D. E. H., & Van de Ven, N. (Eds.) (1990). *Crimes against women: Proceedings on the International Tribunal* (3rd ed.). Berkley, California, Russell Publications.
- Russell, D.E.H. (2011, December), The origin and importance of the term femicide. Gjetur në: https://www.dianarussell.com/origin_of_femicide.html (konsultuar në maj, 2020).
- Russell, D.E.H., & Harmes, R. (Eds.) (2001). *Femicide in global perspective*, New York, Teachers College Press.
- Simonovic, D. (2016). *Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences* (Report 71/398). United Nations General Assembly.
- United Nations Office on Drugs and Crime (2019). *Global study on homicide*.